

V E N D I M
Nr.137, datë 20.3.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.152, DATË 5.4.1994 “PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHITESAVE TË PENSIONEVE”

Në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Ish-të Përndjekurve Politike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.152, datë 5.4.1994 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve”, pika 1 ndryshohet si vijon:

“Pension të posaçëm ose shtesë pensioni shtetëror përfiton personi që plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kur mosha e tij është brenda kufijve të pasqyrave të nenit 92 të ligjit të mësipërm.

Personave që janë cilësuar të paaftë për punë me vendim të K.M.C.A.P.-it mund t’u jepet pension i posaçëm ose shtesë pensioni shtetëror dhe nën kufijtë e moshave të përcaktuara në pasqyrat e nenit 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi